

TEKNOLOGJIA E NUMËRIZIMIT NË ARKIVIN QENDROR SHTETËROR

Vështrim i shkurtër mbi projektin “Modernizimi i arkivave të Shqipërisë”

Përmbledhje

Numërizimi është elementi bazë për modernizimin e arkivave shqiptare për ruajtjen dhe shfrytëzimin e informacionit. Për këtë arsye është ngritur grupi i informatizimit i përbërë nga specialistë të informatikës dhe arkivistë me përvojë, të cilët u përballën me këtë proces bashkëkohor, duke krijuar kështu bazat e një informatike të gjerë kundrejt nevojave të Rrjetit Arkivor Shqiptar. Ata u gjendën përpara sprovave të dy botëve, të së shkuarës dhe asaj moderne. U përballën frontalisht me vështirësitë e numërizimit për ruajtjen e të dhënave me vlerë, për të qenë sa më të qasshme në dispozicion të publikut, për ruajtjen e jetës private, të mirëbesimit dhe të sigurisë së informacionit.

Objekti kryesor i kësaj teme është *Teknologjia e numërizimit në Arkivin Qendror Shtetëror*, që elementi bazë për modernizimin dhe hapjen ndaj publikut të ruajtjes së informacionit, i cili sot është konceptuar si mjeti që thyen kornizat e arkivave si institucione në vetvete. Ndër të tjera, pjesë të këtij punimi janë edhe këto nëntema:

- a) Leksiku i termave, krijimi dhe përdorimi i një metagjuhe të përbashkët në arkivistikën elektronike;
- b) Çështë teknologjia e numërizimit dhe shtrirja e tij në arkiva;
- c) Si u përballën arkivistët me vështirësitë e numërizimit?;
- ç) Konsolidimi i arritjeve të bashkësisë arkivore shqiptare për realizimin e projektit me pjesëmarrjen e Arkivave Federale të Zvicrës.

Fjalë kyçe: *numërizim, terminologji arkivore, metagjuhë, shërbim i dokumentit, teknologji*

Abstract

Digitization is the basic element for the modernization of the Albanian Archives to store and use information. For this reason, an computerization group has been set up consisting of informatics specialists and experienced archivists, who faced this contemporary process, thus creating the basis of a broad informatics against the needs of the Albanian Archival Network. They faced the trials of both the past and the modern world as well as the difficulties of digitization for the storage of valuable data, to be as accessible as possible to the public, to protect the privacy and to trust and secure information.

The main objective of this topic is: Numbering technology in the Central State Archive, - the basic element for modernization and openness to the public of information storage, which today is conceived as a tool that breaks the framework of archives as institutions in themselves.

The following sub-issues are an explanatory part of my paper from the point of view of the project "Modernization of the Archives of Albania":

- a) Vocabulary of terms, creation and use of a common metalanguage in electronic archiving;
- b) The issue of numbering technology and its extension to archives;
- c) How archivists faced the difficulties of numbering?;
- d) Consolidation of the achievements of the Albanian archival community, in the execution of the project with the participation of the Swiss Federal Archives.

Keywords: *digitization, archival terminology, meta-language, access, technology*

Në shoqëritë me prirje pluraliste dhe demokratike, shfrytëzimi i informacionit dhe i arkivave është një nga kushtet themelore, prandaj edhe modernizimi i arkivave është pjesë përbërëse e modernizimit të shoqërisë.³⁵ Në ditët e sotme përdorimi i kompjuterit krijon kushte për pasurimin e dijes njerëzore. Kjo teknologji u jep mundësi të pakufizuar popujve dhe individëve jo vetëm të njihen me njëri-tjetrin, por edhe të bëjnë kërkime e hulumtime reciproke të trashëgimive të ndryshme kulturore e shkencore. Futja e metodave dhe teknologjive të reja bën evolucion dhe revolucion: evolucion në rrugën e zhvillimit të proceseve të punës, revolucion në aspektin e funksionimit në përgjithësi të personelit në arkiva. Mjetet dhe metodat e reja të punës, pra numërizimi dhe gjithë infrastruktura që kërkon realizimin dhe vënien në shfrytëzim e tij në fushën e arkivave, përbëjnë një sfidë të madhe të kohës. Hyrja e teknologjisë së numërizimit u paraqit si një mundësi për demokratizimin e shërbimit, në funksion të lirisë së informimit, të së drejtës së qytetarëve për transparencë, të detyrës së arkivave për të ndikuar në mirëqeverisje. Arkivat, ashtu si dhe institucionet e tjera, ruajnë dhe administrojnë trashëgiminë kulturore të një vendi, të cilat nëpërmjet teknologjive dhe teknikave të reja të përpunimit e të shfrytëzimit, fitojnë vlerat dhe rëndësinë që ato kanë realisht.

Në vendet evropiane numërizimi në arkiva është zhvilluar në vitet '80, ku komunikimi në largësi, brenda një kohe të shkurtër, u bë dukuri masive e cila u bë më e vullshme në vitet '90.

Gjatë këtyre dekadave kemi dëgjuar shumë terma: si arkiva të numërizuar, arkiva virtuale, arkiva të padukshme, arkiva digjitale, numërizim, digjitalizim etj.³⁶ A ka shpjegim leksiku i këtyre termave në shqip?

Në shqip është më e pranueshme fjala numërizim, pasi është shumë e pasur në përdorim. Ajo formohet mbi rrënjën *numër*, prej nga vijnë dhe shumë fjalë të tjera në shqip: numër, numëror, numërtim, numëror etj., ndërsa termi digjitalizim është në modë, një trend i kohës, por nuk është e argumentuar si fjalë për t'u huazuar në shqip. Për të kuptuar këtë është e rëndësishme të bëhet ndërthurja e një metagjuhe të përbashkët në arkivistikën elektronike: - ajo e terminologjisë arkivore me terminologjinë e informatikës. Terminologjia e arkivistikës ka ndikuar në fjalorin e terminologjisë së informatikës për t'i bartur asaj disa terma klasike të vetat, si skedar (fichier), dosje (dossier), fletë (folder), file (fiche), protokoll (ppp), faqe (page), përdorues (user), hyrje (access), këshillueshmëri (consultabilite) etj.³⁷

³⁵ Sh. Sinani, *Jetëgjatësia e dokumentit të numërizuar...*, 2001, f. 7

³⁶ S. Koçi, *Fjalori terminologjik shumëgjuhësh i arkivistikës*, 2001, f. 69

³⁷ Po aty f. 13, 25, 28-29, 32

Si rrjedhojë, sot shoqëria shqiptare është si gjithë kontinenti, një shoqëri mesazherie e cila, krahas ekzistencës së ligjërimit verbal dhe ligjërimit me shkrim, po përballlet edhe me ligjërimit e ndërmjetëm: ligjërimit e numërizuar, për të cilën ende nuk ka rregulla të mjaftueshme.

Teknologjia e shkrimit historik që prej lashtësisë ka zhvilluar në përpjesëtim të zhdrejtë lehtësinë e komunikimit dhe jetëgjatësinë e vetëruajtjes së dokumentit prej natyrës së bartësit. Shkrimet në gur mund të rronin vetvetiu mijëra e mijëra vjet. Shkrimet në metal (monedha, medaljone), po ashtu kishin jetëgjatësi të siguar. Shkrimet në pergamenë mund të rronin më pak se papirusi, por më shumë se letra. Shkrimet në letër mund të rronin më pak se ato në pergamenë, por shumë më tepër se ato të numerizuara. Si e tillë, edhe shqetësimi për jetëgjatësinë e dokumenteve të numërizuara sot është fenomen botëror.

Në Shqipëri fillimi i hyrjes së teknologjisë së numërizimit daton më 1991, kur një informator shqiptar, Agim Çami, arriti ta përcillte mesazhin e parë elektronik. Ky ishte fillimi i një epoke të re për teknologjinë e numërizimit shqiptar, ku ura lidhëse e projektit për “Modernizimin e arkivave shqiptare” ishte mbështetja financiare dhe teknike e Qeverisë zvicerane. Realizimi i këtij projekti u bë i mundur falë mbështetjes aktive dhe pjesëmarrjes të Arkivave Federale të Zvicrës për modernizimin e sistemeve të shërbimit në arkivat e Shqipërisë. Projektet e përbashkëta informatike shqiptaro-zvicerane u zhvilluan përgjatë dy dekadave të partneriteti gjatë tri fazave: 1995-1999, 2001-2003 dhe 2008-2011. (DPA, F. 507, 1995-2000, 2005).

Ç’është numërizimi dhe çfarë favorizon ai?

Numërizimi është proces i krijimit të një forme përfaqësimi dyshifror (me anë të zerove dhe njëshave) të një objekti, i cili mund të jetë tekst, figurë apo tingull që mund të përdoret, ruhet dhe transmetohet duke përdorur teknologji elektronike - kompjuterin. Numërizohen dorëshkrime, dokumente, fotografi, negativa filmi, mikrofilma, diapozitiva, dorëshkrime muzikore, harta, skica, planimetri dhe ilustrime të tjera. Pra, numërizimi është një metodë e re në vazhdimësinë e praktikës së lashtë të shkruarve të dorëshkrimeve të vjetra për ta kopjuar materialin lexueshëm e të qartë, për ta siguruar ruajtjen dhe përcjelljen e përmbajtjes për brezat e ardhshëm.³⁸ Teknologjia e numërizimit krijon të gjitha mundësitë për depozitim, ruajtjen dhe shfrytëzimin e informacionit. Krijon riprodhimin në një cilësi të lartë të një origjinali të dëmtuar dhe jep mundësinë e përhapjes dhe të shpërndarjes së informacionit në kohë të shpejtë.

³⁸ Sh. Sinani, *ibid*, 2001, f. 105

Pse duhet të numërizohen të dhënat?

Sepse sigurohet ruajtja e mjetit apo materialit, ku nëpërmjet krijimit të kopjes së numërizuar shkurtohet përdorimi i origjinalit i cili kryen procesin e mbrojtjes së dokumentit origjinal. Pra, numërizimi krijon kufizimin e përdorimit të drejtpërdrejtë të origjinaleve;

Përmirësohet dhe lehtësohet shfrytëzimi. Numërizimi siguron shfrytëzimin e përmbajtjes së dokumentit, të një dorëshkrimi nga gjithë bota pa qenë nevoja e përdorimit të drejtpërdrejtë të origjinalit. Informacioni i përmbajtur në disa lloje dokumentesh si dorëshkrimet mesjetare, është çështje që i përket njerëzimit, edhe pse është pjesë e një trashëgimie të veçantë kombëtare që zotërohet nga e gjithë bota;

Krijohet një kopjim besnik. Duke krijuar një kopje të numërizuar të cilësisë më të lartë, mund të krijohen kopje të tjera për qëllime ruajtje dhe shfrytëzimi. Mund të shtypen kopje të dokumentit sipas dëshirës, p. sh., për botime pa prekur dhe dëmtuar origjinalin;

Mundësohet zëvendësimi dhe riparimi i shpejtë i dokumenteve origjinale nga dëmtimet dhe keqpërdorimet.

Në fazën e parë e të dytë, për arkivat shqiptare, ishte një situatë e turbullt, sepse për herë të parë rjetit arkivor të vendit i doli përballë një përgjegjësi e re, për ta kushtëzuar fatin e dokumentit qysh në çastin e krijimit, duke vlerësuar si detyrë të parë ruajtjen e dokumenteve. Arkivat e padukshme në Shqipëri u bënë një realitet shumë më shpejt se të krijohehin standardet e mbrojtjes së tyre. Arkivat u përballën me problemin e transformimit të dokumenteve nga formati dhe suporti tradicional në ato elektronike dhe të numërizuara. Ndikimi i këtij transformimi në aktivitetet institucionale të strukturave arkivistike lidhet me tre elementë të rëndësishëm: ruajtja, komunikimi dhe vlerësimi i trashëgimisë. Mjetet dhe metodat e reja të punës, pra numërizimi dhe e gjithë infrastruktura, kërkonte nga arkivistët pajisjen me norma të reja mbi trajtimin e informacionit, hartimin e programeve të reja për formim dhe kualifikim për shfrytëzimin e teknologjive të reja.

Në këtë kohë bashkësia arkivore gjendej në udhëkryqin e dy botëve: të së shkuarës dhe modernes, në mënyrë që të ishin veprues jo vetëm në drejtim të mbështetjes së modernizimit të këtij shërbimi publik kaq të rëndësishëm, por edhe në drejtim të nxjerrjes së skeptikëve ndaj modernizimit, veçanërisht në jetën profesionale si: dyshimi në aftësitë për t'u ngritur në lartësinë e kërkesave të kohës; dëshirapër t'i ruajtur pozitat e arritura; frika, dyshimi deri në mosbesim se futja e teknologjive të reja dhe krijimi i mundësive më të mëdha për afrim të publikut tek informacioni do të shkatërrojë atë çka është krijuar për një kohë të gjatë e që është arritur me mund dhe sakrifica. Ndryshimi thelbësor i raportit formë

(bartës) - përmbajtje (informacion) është se kërkojnë ndryshime thelbësore në praktikat e punës, por jo në synimin themelor për të ruajtur, miradministruar dhe vënë në shërbim të publikut. Në kushtet dhe format virtuale të krijimit dhe qarkullimit të informacionit, sfidë e diktuar nga shoqëria e informacionit, veprimi i arkivistëve duhet të jetë energjik për ta trajtuar prodhimin elektronik të informacionit në të gjitha aspektet e tij.

Në këtë rrugëtim bashkëpunimi, të gjatë dhe të vështirë, përfundoi procesi i arkivimit standard i dokumenteve të numëruara. U hodhën të dhënat mbi 95 % të mjeteve kryesore të kërkimit (inventarëve dhe skedarëve në AQSh), përfundoi procesi i kontrollit dhe verifikimit të mangësive të mundshme teknike, p. sh., (mungesa ose gabime strukturore gjatë hedhjes së të dhënave); u krijua baza e të dhënave të numëruar tëa treguesve emërorë të pronave; përfundoi transferimi elektronik i të dhënave, i cili bën unifikimin e formateve të të dhënave dhe shkurtimin e kostos së migrimit nga institucionet fondkrijuese në databazën qendrore pranë Arkivit Qendror Shtetëror; aplikimet për kërkimin e dokumenteve në dispozicion të përdoruesve do të shërbejnë: Scope, Query, Tep etj., të cilat i japin mundësi përdoruesit për rritjen e performancës të proceseve të punës; përfundoi shtrirja e procesit të digjitalizimit të mjeteve të informacionit në Arkivat Vendore Shtetërore; u krye digjitalizimi i fototekës; u numëruan mjetet e informacionit dhe lidhja e tyre me dokumentin origjinal - skanimi i fotove; përfundoi me kohë automatizimi i komunikimit sallë-lexim-depo; u krye skanimi i regjistrave (kryesisht të Periudhës Osmane dhe mjaft fonde të rëndësishme). Gjithashtu, është bërë shumë punë për plotësimin e nivelit të infrastrukturës (ndërtesa, siguri, klimatizim); u përmirësua rritja e kapacitetit të ruajtjes së dokumenteve në arkivat qendrore (në ndërtesa dhe në raftet e lëvizshme).

Faza e tretë u konceptua së pari ta kryejë konsolidimin e arritjeve të programeve të mëparshme drejt modernizimit të institucionit arkivistik shqiptar dhe, së dyti, që ta rrisë profesionalizmin, me qëllim përgatitjen e përfundimit të bashkëpunimit, ku DPA do të vazhdojë vetë pa ndihmën e programit zviceran.

Bashkësia arkivore është e përgjegjshme për realitetin e sotëm. Në pak vite numëruimi u bë një mjet i domosdoshëm për përpunimin dhe përhapjen e të dhënave arkivore. Ajo është e ndërëgjegjshme se nuk mund të numërizohet gjithçka, madje as të numërizohen të gjitha dokumentet që meritojnë vëmendje. E parë në syrin e perspektivës duket se ai do të tejkalojë të qenit thjesht një formë moderne e mikrofilmit. Faktikisht, numëruimi në format më të përparuara të tij mundëson krijimin e dokumenteve virtuale shumë më të thjeshta për t'u përhapur e shfrytëzuar sesa dokumentet tradicionale.

Sot nuk shtrohet thjesht problemi i administrimit të arkivave dhe të informacionit arkivor. Realitetet e botës virtuale shtrojnë problemin e administrimit të dijes për informacionin krahas administrimit të informacionit. Procesi i numërizimit mbështet ruajtjen e originalit për të cilin ekziston rreziku i manipulimit apo shkatërrimit të karakteristikave dhe elementëve përbërës të tij. Mbrojtja e fondeve, me të dhënat e ruajtura në sistemet informatike, ndaj çdo lloj qasje të paautorizuara ose abuzive, është e garantuar nëpërmjet disa masave fizike të organizimit dhe teknike.

Së fundi, mbetet ende për t'u parë me vëmendje çështja e ruajtjes afatmesme dhe afatgjatë e formës numerike të dokumentit. Prandaj edhe shqetësimi i jetëgjatësisë së dokumenteve të numërizuara sot është problem botëror. Pra, numërizimi, krahas hapësirave dhe përparësive, ka edhe problemet dhe kufizimet e tij. Të gjitha këto kërkojnë që në këtë drejtim duhet ecur, por me një politikë numërizimi të mirëmenduar, koherente dhe të bashkërenduar në plan ndërkombëtar. Realizimi me sukses i programit është i lidhur me destabilitetin ekonomik, politik dhe social të vendit. S'na mbetet gjë tjetër veçse të jemi optimistë për të ardhmen, sepse potencialet për realizimin e projektit qëndrojnë te sukseset e arritura gjatë ekzekutimit të programeve të mëparshme të zhvilluara në tri fazat e tij dhe në përvojat e fituara. Programet dhe rezultatet e tyre kanë bërë të mundur që të ndërtojmë pak nga pak një bashkëpunim të fortë dhe të avancuar në mënyrë efikase për modernizimin e arkivave në Shqipëri. Këto rezultate të fituara ndihmojnë të nxjerrim një mësim pozitiv nga e shkuara dhe të bëjmë që bashkëpunimi me partnerët vendas të zhvillohet më së miri për t'i arritur objektivat me sukses në të ardhmen.

Referenca:

Burime arkivore:

F. 507, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (1995). *Letërkëmbim rreth projektit të ndihmës për informatizimin e arkivave* (dosja 141)

F. 507, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (1997). *Letërkëmbim ndërmjet DPA e Arkivave Federale të Zvicrës dhe kërkesë për ripërtëritjen e marrëveshjes në lidhje me programin "Modernizimi i arkivave shqiptare" me ndihmën dhe financimin e Arkivave Zvicëranë* (dosja 111, 134-135)

F. 507, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (1998). *Letërkëmbim ndërmjet DPA e Arkivave Federale të Zvicrës në lidhje me programin "Modernizimi i arkivave shqiptare"* (dosja 101)

F. 507, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (1999). *Letërkëmbim ndërmjet DPA e Arkivave Federale të Zvicrës në lidhje me programin "Modernizimi i arkivave shqiptare" në kuadër të bashkëpunimit dypalësh* (dosja 58)

F. 507, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (2000). *Letërkëmbim ndërmjet DPA e Arkivave Federale të Zvicrës në lidhje me programin "Modernizimi i arkivave shqiptare"* në kuadër të bashkëpunimit dypalësh (dosje 113-114)

F. 507, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. (2005). *Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për modernizimin e arkivave shqiptare* në kuadër të bashkëpunimit dypalësh (dosja 230)

Burime dytësore:

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave: Dokumenti i numëruar. (2001). *Sinteza dhe përvoja evropiane*

Koçi, S. (2001). *Fjalori terminologjik shumëgjuhësh i arkivistikës*. Publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 2001

Pustina, B. (2001). *Numërizimi - metodologji e re e informimit dhe komunikimit, Arkivat shqiptare*, (viti 3, nr. 2)

Sinani, Sh. (2001). *Jetëgjatësia e dokumentit të numëruar dhe disa probleme të besueshmërisë së tij, Arkivat shqiptare*, (viti 3, nr. 2)